



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 300/11 Prot.

Gramsh, më 11.05. 2024

V E N D I M

Nr. 29, date 29/02/ 2024

PËR
MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË SIPËRFAQEVE
TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK NË PRONËSI TË BASHKISË
GRAMSH, PËR NDËRTIM DHE OPERIM TË HEC "GRABOVA 1", NGA SHOQËRIA
"GRABOVA HYDROPOWER"shpk".

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 29.02.2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbështetur në Ligjin nr.139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", të Ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kulloros" i ndryshuar, në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive" të ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrit Mjedisit nr.01, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloros publik", në VKM-në nr. 267, datë 27.04.2023 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.559, datë 29.07.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Këshilli Bashkiak :

V E N D O S I :

1. Të shpreh dakortësinë për vijimin e procedurave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kulloros publik, për ndërtimin dhe operimin e Hec "Grabova 1" nga Shoqëria "GRABOVA HYDROPOWER"shpk për sipërfaqen e kërkuar prej 2.126 km, në nëngastrat pyjore nr.96a (1.353km) dhe 96b (0.037km) për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim me rrjetin rrugor egzistues që shtrihet në ekonominë pyjore "Dushku i Bulçarit", në nëngastrat pyjore nr.62c (0.318km), 62b (0.013km) dhe 64b (0.405km) për ndërtim kanali mbi sipërfaqe që shtrihet në ekonominë pyjore "Suhagorë -Mali i Grabovës".

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

ENIS ZANI

